

VENDIM
Nr. 539, datë 19.9.2018

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE
EKONOMISË (MARRËSI) DHE SHOQËRISË RAJONALE TË MENAXHIMIT TË
MBETJEVE TË KORÇËS (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT), DHE KfW
FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR PROJEKTIN “MENAXHIMI I MBETJEVE TË
NGURTA NË SHQIPËRINË JUGLINDORE, MASA SHOQËRUESE,
FAZA 2 (RAJONI KORÇË)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi) dhe Shoqërisë Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve të Korçës (Agjencia e Zbatimit të Projektit) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për financimin e projektit “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipërinë Juglindore, masa shoqëruese, faza 2 (Rajoni Korçë)”, nëpërmjet një granti në shumën 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) euro, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE FINANCIMI

DATE 2.8.2018, NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE
EKONOMISË (MARRËSI) DHE SHOQËRISË RAJONALE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE
TË KORÇËS (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTTIT), PËR SHUMËN 1,200,000.00 EURO,
MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA NË SHQIPËRINË JUGLINDORE, MASAT
SHOQËRUESE, FAZA 2 (RAJONI KORÇË)
BMZ ID 2014 701 03

Mbi bazën e Marrëveshjes së datës 28 tetor 2016 ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi “Bashkëpunimin Financiar” (**Marrëveshja Qeveritare**), Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja lidhin Marrëveshjen e mëposhtme të Financimit.

Kjo Marrëveshje Financimi “Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta në Juglindje të Shqipërisë - Masat Shoqëruese, faza 2” është pjesë e projektit “Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta të Shqipërisë Juglindore” dhe projekti “Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta të Shqipërisë Juglindore - Masat Shoqëruese” dhe është burimi financues për mbështetje të mëtejshme institucionale në projektet e lartpërmendura. Projekti është në zbatim dhe financohet nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje të Financimit, Marrëveshjes së Huas, Financimit dhe Projektit, të datës 28 dhjetor 2012 (**Marrëveshja e Huas dhe e Financimit**) dhe Marrëveshjes së Financimit të datës 28 dhjetor 2012 (**Marrëveshja e Financimit - Masat Shoqëruese**).

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW-ja do t'i japë Marrësit një kontribut financiar që nuk tejkalon 1,200,000.00 euro.

Ky kontribut financiar nuk do të shlyhet, përveç kur përcaktohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Marrësi do t'i kanalizojë plotësisht kontributin financiar Agjencisë së Zbatimit të Projektit në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit do të përdorë kontributin financiar ekskluzivisht për shërbime të ekspertëve për projektin “Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta në Shqipërinë Juglindore (Shërbimet e Ekspertëve) për të mbështetur veten, komunitetet pjesëmarrëse dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe, kryesisht, për të paguar kostot e këmbimit valutor. MIE, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet dhe objektin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe mallrave dhe shërbimeve që do të financohen nga kontributi financiar me një marrëveshje të veçantë (**Marrëveshja e Veçantë**), e cila do të bihet dakord nga Marrësi i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

1.3 Marrësi dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësisht kontributet homologe që do të jepen nga Marrësi në Marrëveshjen e Veçantë. Marrësi do të japë kontributet e tij të plota dhe në kohën e duhur. Marrësi do t'i japë KfW-së, sipas kërkesës, dëshmi që provojnë masat e marra për këtë qëllim.

1.4 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që do të lindin nga Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga kontributi financiar.

Neni 2

Kanalizimi i kontributit financiar në Agjencinë e Zbatimit të Projektit

2.1 Marrësi do të kanalizojë kontributin financiar në Agjencinë e Zbatimit të Projektit, si një grant të pashlyeshëm, sipas një marrëveshjeje financimi të veçantë.

2.2 Para disbursimit të parë nga kontributi financiar, Marrësi i dërgon KfW-së një përkthim të certifikuar në anglisht të Marrëveshjes së përmendur në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i kontributit financiar nuk përbën përgjegjësi të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja do të disbursojë kontributin financiar në pajtim me progresin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe me kërkesë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Me një Marrëveshje të Veçantë, e cila do të bihet dakord nga Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia për Zbatimin e Projektit, MIE dhe KfW-ja do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti, dëshmitë që vërtetojnë se fondet e disbursuara përdoren për qëllimin e caktuar.

3.2 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë kryerjen e disbursimeve pas datës 31 dhjetor 2021 ose një datë tjetër, siç mund të bihet dakord ndërmjet dy palëve.

Neni 4

Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç në rastet kur:

- a) Marrësi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për të kryer pagesa kur bëhen të kërkueshme;
- b) Janë shkëlur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Huas dhe Financimit, Marrëveshjes së Financimit - Masat Shoqëruese ose sipas marrëveshjeve të veçanta të lidhura me këto Marrëveshje;
- c) Agjencia për Zbatimin e Projektit nuk mund të dëshmojë se kontributi financiar është përdorur për qëllimin e caktuar;

d) Përmbushja e detyrimeve të KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin në fuqi; ose
e) Lindin rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin ose qëllimin e Shërbimeve të Ekspertëve.

4.2 Nëse ndonjë nga situatat e specifikuar në nenin 4.1(b), (c) ose (d) ka ndodhur dhe nuk është zgjidhur brenda një periudhe të caktuar nga KfW-ja, periudhë e cila megjithatë duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) Në rastin e specifikuar në nenin 4.1(b) ose (d), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) Në rastin e përcaktuar në nenin 4.1(c), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të këtyre shumave që Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë se janë përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 5

Shpenzimet dhe pagesat publike

Marrësi do të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që lindin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe të konvertimit që rrjedhin në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 6

Deklaratat kontraktuale dhe fuqia e përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat e caktuar prej tij/saj për KfW-në, dhe të autorizuar me nënshkrimet model të vërtetuara prej tij ose saj do të përfaqësojnë Marrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Administratori i Përgjithshëm i Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar me nënshkrime model të vërtetuara prej tij ose saj, do të përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve. Kompetencat e përfaqësimit nuk do të përfundojnë derisa KfW-ja të ketë marrë revokimin e tyre të shprehur nga përfaqësuesi i autorizuar në atë kohë.

6.2 Amendamentet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo njoftim dhe deklaratë e dorëzuar nga palët kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet të bëhen me shkrim. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që cenojnë vetëm marrëdhëniet juridike ndërmjet KfW-së dhe Marrësit nuk do të kërkojnë pëlqimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo amendament që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet në këtë Marrëveshje që ndikojnë vetëm në periudhën e disponueshmërisë (neni 3.2) nuk do të kërkojnë miratimin paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim ose deklaratë që duhet të bëhet në lidhje me këtë Marrëveshje do të jetë marrë pasi të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës korresponduese kontraktuese ose në ndonjë adresë tjetër të palës kontraktuese korresponduese që i njoftohet palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në:

KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Republika Federale e Gjermanisë

Faks: +49 69 7431-2944

Për marrësin: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Faks: +355 4222 8494

*Për Agjencinë Zbatuese të Projektit:
“Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë” sh.a. (KRWM sh.a.)
Rruga “Bardhyl Pojani”, l.2, pallati 3, kati I/1,
Korçë, Shqipëri*

Neni 7

Shërbimet e ekspertëve

7.1 Agjencia e Zbatimit të Projektit

a) Do të përgatisë dhe do të kryejë Shërbimet e Ekspertëve në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale dhe, kryesisht, në përputhje me konceptimin e rënë dakord ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së dhe për këtë qëllim do të përfitojë nga shërbimet e inxhinierëve të pavarur të kualifikuar konsulentë;

b) Do të mbajë ose do të marrë masa për mbajtjen e librave dhe regjistrave që pasqyrojnë qartë të gjitha kostot e shkaktuara në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe që identifikojnë qartë shërbimet e financuara nga ky kontribut financiar;

c) Do t’u mundësojë përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë që të inspektojnë librat dhe regjistrat në fjalë dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm për Zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve; dhe

d) Do t’i japë KfW-së të gjithë informacionin dhe të dhënat mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe për përparimin e tyre të mëtejshëm që mund të kërkojë KfW-ja.

7.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit, MIE dhe KfW-ja, do të përcaktojnë detajet e lidhura me nenin 7.1 me një Marrëveshje të Veçantë, e cila do të bihet dakord nga Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

7.3 Marrësi, nëpërmjet MIE-s dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit, do të:

a) Sigurojë financimin e plotë të Shërbimeve të Ekspertëve dhe, sipas kërkesës, do t’i dorëzojë KfW-së dëshmi që vërtetojnë se shpenzimet që nuk paguhen nga ky kontribut financiar janë siguruar; dhe

b) Njoftojë vullnetarisht KfW-në menjëherë për të gjitha rrethanat që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin ose qëllimin e Shërbimeve të Ekspertëve.

7.4 Marrësi, nëpërmjet MIE-s do të asistojë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në përputhje me praktikat e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe në përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, t’i japin Agjencisë së Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve.

7.5 Për transportin e mallrave që do të financohet nga kontributi financiar do të zbatohen dispozitat e Marrëveshjes Qeveritare, të cilat njihen nga Marrësi.

Neni 8

Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Shërbimet e Ekspertëve

8.1 Në përputhje me parimet e pranuar ndërkombëtarisht të transparencës maksimale dhe efikasitetit në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën se si financohen gjatë bisedimeve parakontraktuale, ndërsa marrëveshja/et e lidhur/a me Shërbimet e Ekspertëve është/janë duke u zbatuar dhe në një fazë pas kontraktimi (në vijim e referuar si **“Periudha e Plotë”**).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e saj të biznesit “KfW Development Bank”: <http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de>.

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja, ose palët e treta në pajtim me nenin 8.3 më poshtë), në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën se si ato financohen nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose ndonjë informacion të detajuar sensitiv financiar ose biznesi në lidhje me palët e përfshira

në Shërbimet e Ekspertëve ose financimin e tyre, të tilla si:

- a) Informacion për të dhëna të brendshme financiare;
- b) Strategjitë e biznesit;
- c) Udhëzimet dhe raportet e brendshme të korporatës;
- d) Të dhënat personale të personave fizikë;
- e) Vlerësimin e brendshëm të KfW-së mbi pozicionin financiar të palëve.

8.2 KfW-ja ndan informacione të përzgjedhura mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën se si janë financuar gjatë Periudhës së Plotë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet me subjektet e poshtëpërmendura:

- a) Filialet e KfW-së;
- b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet e saj kompetente, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet,
- c) Organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin dypalësh të zhvillimit gjerman, veçanërisht, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH,
- d) Organizatat ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarëve të tyre, veçanërisht, Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacione të zgjedhura në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën se si financohen gjatë të gjithë Periudhës së Plotë, me subjektet e mëposhtme, të cilat publikojnë pjesët e lidhura me qëllimin e caktuar;

a) Republika Federale e Gjermanisë, për qëllime të Iniciativës së Transparencës së Ndhmës Ndërkombëtare: http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenzfuermehrWirksamkeit/index.ht;

b) Tregu dhe Investimi Gjerman (GTAI), për qëllime të informacionit të tregut: http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/t_rade.FOO;

c) OECD-ja për qëllimin e raportimit të flukseve/qarkullimeve financiare në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim: <http://stats.oecd.org/>;

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval), për qëllime të vlerësimit të bashkëpunimit të përgjithshëm të zhvillimit gjerman për të garantuar transparencë dhe eficiencë (<http://www.deval.org/de/>).

8.4 KfW-ja, gjithashtu, rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë edhe për qëllimet e publikimit) informacion në lidhje me shërbimet e ekspertëve dhe mënyrën se si financohen gjatë Periudhës së Plotë ndaj palëve të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të Marrësit dhe/ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit në informacionin që nuk transferohet i tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Marrësit dhe/ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit, në veçanti përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në nenin 8.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion për palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregullatore, ose për të pohuar ose për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

Neni 9

Dispozita të ndryshme

9.1 Marrësi, nëpërmjet MIE-s dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit, do të sigurojë që personat e ngarkuar me përgatitjen dhe zbatimin e Shërbimit të Ekspertëve, dhënien e ndonjë kontrate për shërbimet e ekspertëve që do të financohen, dhe me kërkesën e disbursimeve të shumave të kontributeve financiare, të mos kërkojë, marrë përsipër, ofrojë, japë, premtojë ose marrë premtim për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

9.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit do të vërë menjëherë në dispozicion të KfW-së, me kërkesë, të gjitha informacionet dhe dokumentet që KfW-ja kërkon për të përmbushur detyrimet e saj, për të

parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit, e cila është e nevojshme për këtë qëllim.

Në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emër dhe për llogari të vet. Në lidhje me ligjin gjerman ose me ligjin e vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit .

a) Burimet vetjake të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ose shumat e investuara në financimin e Shërbimeve të Ekspertëve, nuk do të jenë me origjinë të paligjshme dhe, në veçanti, ndërsa kjo listë nuk është shteruese, të cilat kanë lidhje me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin;

b) Kapitali aksionar i Agjencisë së Zbatimit të Projektit nuk do të jetë në asnjë kohë me origjinë të paligjshme dhe, në veçanti, ndërsa kjo listë nuk është shteruese, nuk do të kenë lidhje me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të angazhohet në blerjen, zotërimin ose përdorimin e pronës me origjinë të paligjshme dhe, në veçanti, ndërsa kjo listë nuk është shteruese, të cilat kanë lidhje me trafikimin e drogës, korrupsionin, krimin e organizuar ose terrorizmin; dhe

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të angazhohet në financimin e terrorizmit.

9.3 Agjencia e Zbatimit të Projektit përfaqëson/garanton se nuk ruan asnjë marrëdhënie biznesi ose që nuk është angazhuar në ndonjë aktivitet tjetër:

a) Me ose në favor të personave, organizatave ose subjekteve të renditura në listën e sanksioneve të lëshuar nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë (**Listat e Sanksioneve**); ose

b) Që do të përbënte një shkelje të embargove, rregullatore të tregtisë së jashtme ose të të ashtuquajturave sanksione financiare, të lëshuara nga institucionet e lartpërmendura (së bashku të referuara si **“Sanksionet”**).

Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të hyjë ose nuk do të vazhdojë asnjë marrëdhënie biznesi me persona, organizata ose subjekte të renditur në Listën e Sanksioneve dhe nuk do të angazhohet në ndonjë aktivitet tjetër që do të përbënte shkelje të sanksioneve.

Agjencia e Zbatimit të Projektit do të informojë KfW-në menjëherë dhe personalisht, për çdo rast që ndodh, në cilëndo nga Agjencitë e Zbatimit të Projektit, çdo anëtar të organeve të tij të menaxhimit ose organeve të tjera qeverisëse ose ndonjë prej aksionarëve të saj që renditet në Listën e Sanksioneve.

9.4 Marrësi nuk do të hyjë në ndonjë transaksion ose nuk do të angazhohet në ndonjë aktivitet tjetër në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve që do të përbënte shkelje të sanksioneve.

9.5 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara. Çdo boshllëk që rrjedh prej tyre duhet të plotësohet nga një dispozitë që është përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.6 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të caktojnë/delegojnë ose transferojnë, garantojnë ose mbajnë peng/hipotekojnë asnjë kërkesë nga kjo Marrëveshje.

9.7 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i përmbushjes do të jetë Frankfurt am Main.

9.8 Marrëdhëniet juridike të vendosura nga kjo Marrëveshje midis KfW-së, Marrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit do të përfundojnë me përfundimin e kohëzgjatjes së shërbimeve të ekspertëve, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

9.9 Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi pasi KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim të Marrësit se procedurat e brendshme ligjore që duhet të përmbushë Marrësi janë përfunduar.

Hartuar në tre (3) origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,
më 2 gusht, 2018
KfW

Tiranë,
më 30 korrik 2018
Republika e Shqipërisë,
e përfaqësuar nga
Ministria e Financave dhe Ekonomisë,
Tiranë,
më 5 korrik 2018
Shoqëria Rajonale e Menaxhimit të
Mbetjeve, Korçë (KRWM)